



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 11
15.07.2019

NR. VENDIMI 12
24.09.2019

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë e përbëre prej:

Fran PRENDI - gjyqtar

Asistuar nga sekretare **Olivia Myftiu, ne Tirane sot me date 24.09.2019**, mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore, kerkesen penale që perket ;

KERKUES : Përsonat nën hetim pasurorë:

- **A.M.**, i biri i A. dhe i F., i datëlindjes xx.x.xxxx, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë rruga “xxxx xxxx”, banesa me nr.116., Njësia Bashkiake nr.11, Bashkia Tiranë, me shtetësi Shqipëtare.
- **E.V.**, i biri i Sh. dhe i M., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë, me shtetësi Shqipëtare.

Kërkesa është paraqitur nga mbrojtësit e zgjedhur, **av.E. C.dhe av.Radovan Çela**, ortak në studion ligjore “*Çela & Associates Laë Firm*” sh.p.k, me numër NIPT-i, L71424021N, Dhoma e Avokatisë Tiranë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përfaqësuar nga **prokuroret E. N.dhe D. M.**

OBJEKTI I KËRKESËS: Revokimin e vendimit nr.6, datë 21.06.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për sekuestrimin e pasurisë.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.10192, datë 03.12.2009 “*PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT DHE KORRUPSIONIT NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË (ndryshuar me ligjin nr.24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017)*”

Gjykata, pasi verifikoi konform nenit 348 të K.Pr.Penale paraqitjen e palëve, degjoi kërkesen e personit nën hetim pasuror A.M., i cili kërkoi pushimin e gjykimit pasi deklaroi se heq dore nga gjykimi i kërkesës penale, shqyrtoi kërkesen e depozituar me shkrim nga mbrojtësi si përfaqësues i dy përsonave nën hetim, av. R. Ç. me të cilën deklarohet heqja dorë nga gjykimi i kësaj kërkesë, dëgjoi prokurorin e pranishëm E.

N., i cili kërkoi pushimin e gjykimit të kërkesës;
Gjykata si shqyrtoi aktet perkatëse shkresore,

K O N S T A T O I :

Me datë 19.6.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka paraqitur kërkesë me objekt sekuestrim pasurie kundër shtetasve K.C., E.L., A.M., E.V. dhe A.V., me persona të tretë O.(P.) V. dhe A.D., në bazë të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjerë, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin nr. 24/2014 dhe me ligjin nr. 70/2017 dhe, kjo Gjykatë, në bazë të nenit 12 të këtij ligji, për shqyrtimin e kësaj kërkesë, brenda afatit pesë ditor, pa praninë e palëve, në Dhomë Këshillimi, **me vendimin nr.6, datë 21.6.2019 ka vendosur:**

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

2. Sekuestrimin e pasurive si më poshtë vijon:

1. Shuma prej 3,360,130 (tremilion e treqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë) euro, e ndodhur në bankën Intesa Sanpaolo Bank, sh.a, Tiranë, si dhe shuma prej 80,000 (tetëdhjetë mijë) franga zviceriane e ndodhur në bankën Intesa Sanpaolo Bank, sh.a, Tiranë.

2. Shuma prej 72 000 (Shtatëdhjetë e dy mijë) euro, e ndodhur në llogarinë e Shoqërisë “Tirana Rental Car” sh.p.k me numër llogarie xxx, pranë Raiffeisen Bank sh.a, Tiranë.

3. Pasuria nr. 11/35, e llojit truall, me sipërfaqe 404.5 m² + Godinë banimi 2-kate, me sipërfaqe banimi kati përdhe 147.6 m², sipërfaqe verandë + shkallë 10.9 m²+ sipërfaqe banimi kati i parë 158.5 m², në emër të shtetasit O. (P.) M. V., (babai i shtetasit A.V.), ndodhur në Zonen Kadastrale 8130, Volumi 32, faqe 96, sipas shënimeve në Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme, ku, kjo pasuri është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, më datë 22.6.2017 dhe ka shënimin: “Leje Legalizimi nr. 995746, datë 18.11.2016.

4. Pasuria nr. 152/40, Zona Kadastrale 1522, Volumi 7, Faqe 12, e llojit Ranishte me sipërfaqe 140 m², e ndodhur ne fshatin Draç, Ishëm ne Gjirn e Lalzit Durrës, në emër të shtetasit A.A.M., ku, sipas shënimeve në Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme rezulton se, kjo pasuri është regjistruar më datë 28.9/2016, në bashkëpronësi të shtetasve A.D. dhe A.M.

5. Pasuria nr. 148/18, Zona Kadastrale nr.1522, Volumi 5, Faqe 239, e llojit Toke Are me sipërfaqe 873 m², e ndodhur ne fshatin Draç, Ishëm, ne Gjirin e Lalzit Durrës, ku, sipas shënimeve në Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme rezulton se, kjo pasuri është e regjistruar më datë 7.3.2015, në bashkëpronësi të shtetasve A.D. dhe A.M.

6. Pasuria nr. 152/27, Zona Kadastrale nr.1522, Volumi 5, Faqe 231, e llojit Ranishte, me sipërfaqe 11 167 m², e ndodhur ne fshatin Draç, Ishëm ne Gjirn e Lalzit, Durrës, ku, sipas shënimeve në Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme rezulton se, kjo pasuri është e regjistruar më datë 17.3.2015, në bashkëpronësi të shtetasve A.D. dhe A.M.

3. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të ngarkohet znj. Edlira Preça, e cila është administratore e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

4. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet oficerët e policisë gjyqësore K. Gj. dhe C. K., oficer policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilët pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009, detyrohen që t'i bëjnë njoftimin e këtij vendimi personave që ju janë sekuestruar pasuritë dhe që janë përmendur në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Sipas akteve të dosjes rezulton se personat nën hetim pasurorë A.M.dhe E.V. kanë zgjedhur mbrojtës, av. E. C.dhe av. Radovan Çela, ortak në studion ligjore “Çela & Associates Laë Firm“sh.p.k, me numër NIPT-i, L71424021N, Dhoma e Avokatisë Tiranë. Vullneti i tyre është dokumentuar në aktet noteriale, prokurë e posaçme me nr.160 rep., nr.80/2 kol., datë 17.07.2018 dhe prokurë e posaçme me nr.1055 rep., nr.585/1kol., datë 19.07.2018.

Me datë 15.07.2019 nga pala kërkuese, personat nën hetim pasurorë A.M.dhe E.V., nëpërmjet mbrojtësve të zgjedhur av. E. C.dhe av. Radovan Çela, është depozituar në sekretarin e kësaj gjykate kërkesa object shqyrtimi. Nëpërmjet kësaj kërkesë pala kërkuese kërkon revokimin e vendimit nr.6, datë 21.06.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për sekuestrimin e pasurisë sa më sipër(kërkesa rezulton se është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur av.Radovan Çela).

Në seancën e sotme gjyqësore u administrua kërkesa me shkrim e paraqitur nga mbrojtësit av.E. C.dhe av.Radovan Çela si përfaqësues të palës kërkuese të cilët shpreheshin se hiqnin dorë nga kërkesa e paraqitur. Përsoni nën hetim A.M. u shpreh dakort me kërkesën e parashtruar nga mbrojtja për pushimin e gjykimit të kërkesës pasi heqnin dorë nga gjykimi në lidhje me këtë kërkesë penale, prokurori gjithashtu u shpreh se në kushtet kur pala kërkuese ka hequr dorë nga gjykimi duhet të vendoset pushimi i gjykimit të kërkesës.

Ne të tilla kushte, kur pala kërkuese deklaroj se ka hequr dorë nga kërkesa penale, kërkesë e cila ka vënë në lëvizje gjykatën, gjykata çmon se nuk ka lënde (objekt gjykimi) për të gjykuar dhe për pasoje sikundër edhe kërkuan palet duhet vendosur pushimi i gjykimit të kësaj kërkesë penale.

P R A N D A J,

Gjykata, bazuar në nenet 5/2, 22/1 të Ligji nr.10192, datë 03.12.2009 “PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT DHE KORRUPSIONIT NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË (ndryshuar me ligjin nr.24/2014, datë 20.3.2014, nr.70/2017, datë 27.4.2017) si dhe nenin 112 të K.Pr.Penale,

V E N D O S I :

-Pushimin e gjykimit të kërkesës penale me nr.11 akti, datë 15.07.2019 regjistrimi, me kërkesë Përsonat nën hetim pasurorë, A.M. dhe E.V. , Subjekt i

Interesuar Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, *me objekt* Revokimin e vendimit nr.6, datë 21.06.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për sekuestrimin e pasurisë.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga palët brenda afatit ligjore në Gjykatën e Aepelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall në Tiranë, sot me datë 24.09.2019

SEKRETARE

Olivia MYFTIU

GJYQTAR

Fran PRENDI

